



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 14 Prot.

Tiranë, më 05.05.2020

URDHËR

Nr. 32, Datë 05.05.2020

PËR

MIRATIMIN E PERIUdhËS SË APLIKIMEVE ME FORMULARËT A1/A1Z PËR MSH 2020

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.537, datë 08.11.2019, "Për miratimin e Rregullores së Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë",

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e periudhës së aplikimeve me formularët A1/A1Z, për MSH 2020, **në datat 19 deri më 24 Maj 2020.**
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Arsimore Vendore dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Rezana VRAPI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM